



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 990/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dega në Prishtinë, paraqitur kundër Pajtim Lubovci, Komina e Lipjanit për shkak të fotografimit të votës parregullsive për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 02.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës me të cilën pretendohet se me datën 01.12.2013 në Komunen e Lipjanit , në vendvotimin nr.1301e/04 Pajtim Lubovci me numer personal 1230426119 ka bërë fotografimin e votës . Rasti është i evidentuar edhe në librin e votimit . Fotografim të votës ka pasur edhe në vendvotimin nr.03, të po të njejtës qendër të votimit, mirpo Kryetari i Komisionit nuk ka ofruarë të dhëna për identitetin e votësve . Vëzhguesi i KDI e ka pasur të pamundur të marr të dhënat personale të këtyre personave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga Instituti Demokratik të Kosovës dega në Prishtinë, janë të pabazuara, dhe të pa argumentuara, andaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i përgjithshëm dhe i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse nga shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë shtese ankesës së parashtruar, me të cilat do të mund të administrohej lënda, ose do të mund të verifikohesh vërtetësia e shkeljes së pretenduar. Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljet që janë cekur në ankesë , PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 990/2013 më datën 04.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.